



Nr. 300 prot.

Data 13.04.2011

Universiteti Shtetëror i Tetovës - Republika e Maqedonisë
Академски Универзитет во Тетово - Република Македонија

Nr.-Бр. 10-2043/1 prot.

13.04.2011 13.04.2011
Data Tetova - Tetovo - 2011

Me qëllim të zhvillimit të bashkëpunimit akademik në arsimin e lartë dhe në pajtim me qëllimet
dhe interesat e përbashkëta, palët në Marrëveshje, më 13.04.2011, në TETOVSË,
lidhin këtë:

MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM

lidhur ndërmjet

1. Universitetit Shtetëror të Tetovës, nga Tetova, i përfaqësuar nga Rektori i këtij Universiteti,
Prof. Dr. Agron REKA;

dhe

2. Akademisë së Arteve, nga Tirana, Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Rektori i saj, **Prof. Petrit MALAJ**, nga ana tjetër.

Neni 1

Marrëveshja për bashkëpunim dëshmon qëllimin e të dy institucioneve që të fillojnë dhe zhvillojnë
bashkëpunim të ndërsjellë në procesin e edukimit dhe punën kërkimore-shkencore.

Neni 2

Palët në Marrëveshje pajtohen që bashkëpunimin ta realizojnë përmes formave të shkëmbimit, të cilat
do të kenë për qëllim përfitimin e diturive dhe përvojave të reja rë sferat e të arriturave më të larta
evropiane dhe botërore, në arsim, shkencë dhe veprimtari aplikative.



Neni 3

Palët në Marrëveshje pajtohen që së pari të vendosin dhe zhvillojnë forma të shkëmbimit të ndërsjellë të kuadrit mësimdhënës dhe bashkëpunëtorëve, për realizimin e ligjëratave ose veprimtarive të tjera mësimore, si dhe për punë hulumtuese nga fushat që janë me interes të përbashkët.

Neni 4

Përveç shkëmbimit, sipas nenit 3 të kësaj Marrëveshje, palët në Marrëveshje pajtohen që:

- bashkërisht të marrin pjesë në programet arsimore dhe shkencore të finançuara nga Bashkimi Evropian;
- të realizojnë projekte kërkimore-shkencore me interes të përbashkët;
- së bashku të organizojnë konferenca shkencore, simpoziume, seminare, punëtori shkencore ose profesionale;
- të shkëmbejnë libra, revista, publikime, botime bibliografike, literaturë shkencore dhe metoda shkencore me interes të përbashkët, si dhe të shkëmbejnë plane dhe programe mësimore për të gjitha ciklet e studimeve;
- të zhvillojnë lloje dhe forma të tjera të bashkëpunimit për të cilat do të pajtohen të dyja palët në Marrëveshje.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj dhe do të zbatohet në periudhën gjatë 5 (pesë) viteve të ardhshme akademike.

Bashkëpunimi mund të vazhdohet edhe pas përfundimit të afatit të përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, me pajtimin e dyanshëm të palëve në Marrëveshje, ose nëse bashkëpunimi vazhdon edhe pas përfundimit të afatit të përcaktuar, pa reagim nga palët në Marrëveshje.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AKADEMIA E ARTEVE
REKTORATI

UNIVERSITETI SHTETËROR

I TETOVËS



Neni 6

Marrëveshja mund të ndryshohet ose plotësohet me pajtimin paraprak nga të dyja palët në Marrëveshje.

Ndryshimi dhe plotësimi i Marrëveshjes do të bëhet me aneks marrëveshje të veçantë, i cili do të jetë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshje.

Neni 7

Kjo Marrëveshje është nënshkruar në katër kopje identike, nga dy kopje pë çdo njërin nga institucionet.

Prof. Petrit MALAJ

REKTOR
AKADEMIA E ARTEVE

Prof. Dr. Agron REKA

REKTOR
UNIVERSITETI SHTETËROR I TETOVËS